



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.559/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Glogocit/Drenasit-Drejtoria per Zhvillim Ekonomik, kunder debitorit N.T.SH "B..T..." B.I, me NUI:811173583, me seli ne Glllogoc/Drenas, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.303/23 të datës 29.09.2023, me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit N.T.SH "B..T..." B.I, me seli ne Glllogoc/Drenas, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.303/23 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.303/23 të datës 29.09.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit N.T.SH "B..T..." B.I, me seli ne Glllogoc/Drenas dhe ka lenë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.03/23 te datës 01.02.2023, te lejuar nga përmbaruesi privat Flamur Curri.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta prish dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rivendosje .

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 31.01.2023, ka paraqitur propozim për përmbuarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbuarues Aktvendimit 05 nr.431/01-28592 të datës 17.06.2022 me të cilën është detyruar debitori N.T.SH "B..T..." B.I, me NUI:811173583, me seli në Gllogoc/Drenas në cilësi të subjektit juridik është ngarkuar me takse komunale në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2022, ndërsa borxhi total është 1,750.00 € për veprimtarinë që e ushtron në territorin e Komunës së Drenasit.

Kundër urdhrimit përmbuarimor debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke njoftuar se ka paguar gjobën e cila ka shërbyer si titull përmbuarimor, pra ka përmbushur në tërësi detyrimin e kërkuar. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar.

Pala kreditor, ka ushtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se tek përmes prapësimin është njoftuar për pagesën e bere nga ana e debitorit, andaj ka propozuar që të vazhdohet procedura dhe të detyrohet debitorit e beje pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbuarimore.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkalles së Parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbuarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar. Andaj në kuptim të nenit 21, 22, dh 23 të LPP, ka marrë vendim si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbuarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrimit të përmbuaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbuarimi i propozuar nga kreditori.

Gjykata Komerciale e Kosovë – Dhomat e Shkalles së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe shkresave tjera, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.303/23 të datës 29.09.2023 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se organi përmbuarues ka lëshuar Urdhrin Përmbuarimor P.nr.03/23 të datës 01.02.2023, në baze të dokumentit përmbuarimor - Aktvendimit 05 Nr.431/01-28592 të datës 17.06.2022 të Komunës së Gllogocit/Drenasit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në kuptim të dispozitave nga neni 21 dhe 22 të LPP-së, pasi që i njëjti është nxjerre në procedure të rregullt administrative nga organi përkatës, është i përshtatshëm për ekzekutim dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, në të tregohet qarte baza juridike dhe lartësia e detyrimit, si dhe shkaqet se nga buron detyrimi i debitorit ndaj kreditorit. Konkretisht sipas këtij vendimi debitori në cilësi të subjektit juridik është ngarkuar me takse komunale në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2022, ndërsa borxhi total është 1,750.00 € për veprimtarinë që e ushtron në territorin e Komunës së

Drenasit. Po ashtu gjykata e shkalles se pare vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit, mirëpo gjeti se te njëjtat nuk mund te jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund te vlerësohen ne këtë procedure, ngase kjo procedure i nënshtrohet parimit te rigorozitetit formal ne baze te cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit te elementeve formale te dokumentit ne baze te cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë se vendimit objekt përmbartimi. Andaj gjykata e shkalles se pare, konstatoi se dokumenti përmbartimor i plotëson te gjitha parakushtet dhe e ka formën e rregullt te aktit qe përmban te gjitha elementet e domosdoshme konform nenit 21, 22.1.2, 23.2, 24.3 dhe nenit 27 te LPP-se.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles e dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkalles e dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi 05 Nr.431/01-28592 të datës 17.06.2022 i Komunës se Glllogocit/Drenasit-Drejtoria per Zhvillim Ekonomik, i formës se prerë nga data 04.08.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 04.09.2022, është dokument përmbartues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se *“dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i dhënë ne procedurë administrative dhe aktpajtimi (ujdia”*, nenit 24 par.3 te LPP i cili thotë se: *“vendimi i dhënë ne procedurë administrative është përmbartimor po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me te cilat është rregulluar procedura e tillë”* si edhe nenit 27 paragrafi 1, i cili thotë se: *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi 05 Nr.431/01-28592 të datës 17.06.2022 përbën titull juridik për përmbartim si dhe konsideron se gjykata e shkalles se parë ka konstatuar drejtë rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbartimit.

Andaj edhe kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë, i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit por qe te njëjtat rezultojnë te pabazuara ne prova dhe fakte konkrete, ashtu siç parashihet me nenin 69.4 te LPP, te njëjtat mbesin vetëm te natyrës deklarative nga rezulton se nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 par.1 te LPP ashtu qe nuk ka kushte për anulim te urdhrin përmbartimor.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Parë
K.DH.SH.II.nr.559/24, me datë 05.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami